



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/267  
Datë: 10/11/2022

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", mbazuar në Rregulloren për studimet e doktoratës me nr. prot. 1/96, datë 24.6.2021, në mbledhjen e mbajtur më 8.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohen listat e kandidatëve për pranim në studimet të doktoratës, sipas propozimeve të njësive akademike (Fakultetit Juridik, Fakultetit të Mjekësisë) dhe të Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës, në programet përkatëse të njësive akademike, mbi bazën e kriterëve të konkursit publik për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2022/2023, me nr. prot. 3/168, datë 27.9.2022.
- II. Kandidatet e pranuar në studimet e doktoratës për vitin akademik 2022/23, do të regjistrohen nga data 14.11.2022 deri me datë 25.11.2022.
- III. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit (ndërtesa e Bibliotekës Qendrore Universitare).
- IV. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
  - Fletëregjistrimin e plotësuar (i cili shkarkohet nga SEMS);
  - Dy fotografi të formatit 6x4 cm;
  - Fletëpagesën (e cila shkarkohet nga SEMS);
  - Pagesa bëhet në një rën prej bankave afariste.
- V. Data e fillimit të ligjëratave, caktohet nga njësitet akademike përkatëse.
- VI. Vendimit i bashkëlidhen pasqyrat me propozimet e njësive akademike.
- VII. Obligohet njësia akademike (Fakulteti i Mjekësisë) që këtë vendim ta publikojnë në ueb faqen e njësive akademike (fakultetit).

**Vendimi t'u dërgohet:**

1. Arkivit të UP-së;
2. Shërbimit për çështje të studentëve në AQ;
3. Fakultetit Juridik;
4. Fakultetit të Mjekësisë;
5. Zyrës për çështje të studentëve;
6. Zyrës Ligjore.



Senati i Universitetit të Prishtinës

*[Signature]*  
Prof. ass. dr. Luljeta Plakolli Kasumi - Kryesuese